

Shkolla e mesme profesionale "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka"

Kaçanik

Ndërtimi i ueb faqes përmes programit Microsoft FrontPage 2003

Udhëzime dhe mënyra e vlerësimit të pikave1. të punës individuale seminarike nga ” teknologjia e informacioni për KL-XII-ta“

Viti shkollor 2011/2012.

Arsimtari i lëndës Ismail Dashi (ismaildashi@gmail.com)

Secili nxënës ndërton një ueb sajt të shkurtër i cili përbëhet nga ueb faqet me fotografi.

Uebi sajt duhet paraqet **uebin personal të nxënësit** me të dhënat që dëshiron ti publikoj mbi vetën. Këto mund të jenë të dhëna biografike, të mësuarit dhe interesat që kanë të bënë me të mësuarit, interesat personale dhe hobi, pasqyrë e veprave (me fotografi) që i ka bërë (fotografi, skulptura, fotografi, etj), foto album personal, ekspozita që ka marrë pjesë vet nxënësi, profesioni, etj..

Rezultati i kësaj pune seminarike duhet të jetë **URL (adresa) sajtit të cilën duhet dërguar me mesazhin në e-mail ismaildashi@gmail.com**. Tema(subjekt) i mesazhit duhet të jetë SHMP: seminari individual”, ndërsa në mesazh duhet dhënë emrin dhe mbiemrin e plotë të nxënësit dhe drejtimin. Nëse nxënësi i ueb sajtit nuk ka pasur sukses ta publikon në ueb server, mund ta punoj seminarin në CDapo DVD apo të njëjtën përmbajtje ta dërgoj nëse ka mundësi në e-mail-in e arsimtarit. Në tabel janë dhënë elementet të cilat duhet ti ketë ueb sajt ose kriteriumet që duhet plotësuar me numrin përkatës të pikave. Numri maksimal që mund të mbledh nxënësi në këtë punë seminarike është **30 pikë**.

Afati i fundit i dorëzimit 31. 04. 2012.

Element	shpjegimi	Poena
Organizimi dhe emërtimi i fajllave	Fajllat HTML dhe fajllat me grafik (GIF, JPG ose PNG) duhet grupuar në të njëjtën direktorium (map). Emrat e fajllave le të mos përmbajnë karaktere diakritike(p.sh.me shkronja siç janë ë, ç në shqip), karaktere të veçanta dhe hapësira.	2
Faqja fillestare (home page)	Faqja fillestare e ueb sajtit (index.htm) paraqet „hyrje“ në sajt dhe duhet përmban të dhëna mbi nxënësin. Në faqen fillestare NUK jepen të dhëna të përgjithshme(të tërë biografjin), por krahas emrit të nxënësit mund të ndodhet fotografia e tij, linku për dërgim të e-mailit të nxënësit autor, linku në faqe të shkollës, link në faqe të komunës, etj.	2
Dizajni i informacionit	Ueb faqja duhet të përbëhet prej më së paku 6 faqeve(faqen e përbën teksti dhe grafika). Duhet mbajtur llogari që faqet s'guxojnë të kenë as tepër as pak përmbajtje. Secila faqe duhet ta ketë titullin kryesor (TITLE) dhe titullin në faqe.	5
dizajni grafikës	Përshtypja vizuale e përgjithshme dhe ngjyrat janë të këndshme për lexim nga ekrani. Teksti është i lexueshëm dhe i shikuar(përdorim të fontit joserif).	5
Dizajn i interfejsit	Shfrytëzohen tabelat për formatizim të tekstit dhe të elementeve të tjerë të ueb faqeve. Hiperteksti (linqet), fotografit dhe elementet e tjerë multimedial përfshihen në ueb sajt duhet të jenë bërë sipas rregullave të një ueb dizajni të mirë.	5
Dizajni navigacionit	Elementet përkatëse për navigim (linqet, tastet ose menytë)duhet përfshihen në secilën faqe të sajtit ku duhet mbajtur llogari mbi rregullat: <ul style="list-style-type: none"> • Qartësia : shfrytëzuesi lehtë vëren navigimin, të gjithë elementet qartë të shënuara, përdoren simbole standard (p.sh. imazh i shtëpisë për kthyerje në ballin-home page) • barazim: elementet për navigacion në secilën faqe të duken njëjtë dhe në të njëjtin vend • Efikasiteti: nuk lypet shumë hapa që të arrihet deri te ndonjë përmbajtje 	5
publikimi	Seminari duhet ndodhet në ueb server dhe të gjitha faqet drejt shfaqen.	2
Elemente shtesë	Të gjitha që u thanë në kategoritë e mëparshme, shembull: tastet për navigim kryesor (në vend të linqeve) dhe elemente të tjerë grafik personal, direktorium fotografish, përdorimi i multimedimeve shtesë), përdorim të programimit shtesë (p.sh. menytë në JavaScript)	4